



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic
of Kosovo



Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Oraovac/Municipal
Assembly Rahovec

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and
Tourism



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and
Tourism

-III- Nr. I prot. 21 Më 05.01.2024
Br. prot. Dt. 05.01.2024
RAHOVEC - ORAHOVAC

Raporti i punës

Janar–Dhjetor, 2023



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and
Tourism

Datë:	05.01.2024
Për:	z.Smajl Latifi, Kryetar i Komunës
Nga:	Erhan Morina-Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Lënda:	Raporti i punës për vitin 2023

DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE TURIZËM

Fushëveprimtaria e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, është e bazuar në aktet normative në fuqi dhe në planifikimin e punës për vitin 2023. Në kuadër të DEZHT-it, gjatë kësaj periudhe raportuese, janë realizuar shumë aktivitete.

TM1, 2023

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, gjatë tre mujorit të parë ka zhvilluar një mori aktivitete:

Gjatë periudhës janar-mars 2023, është bërë regjistrimi i të gjitha subjekteve afariste prej librit kryesor të vitit 2022, në librin e ri të vitit 2023, po ashtu është bërë edhe kalkulimi i ngarkesave për vitin 2023.

Në periudhën janar-mars përmes ankandit publik janë shitur asetet e papërdorëshme të Komunës së Rahovecit, në vlerë: 12,950.00€

Në seancën e rregullt të muajit mars, në K.K Rahovec, DEZHT, ka sponsorizur disa pika:

- Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale për vitin 2022;
- Plotësim - ndryshimi i rregullores për taksa komunale 01 Nr. 80/20;
- Shfuqizimi i vendimit për fabrikën e kartonit, si dhe vendimi për dhënie në shfrytëzim përmes shprehjes së interesit;

- Falja e borxheve të vjetra në taksa afariste për periudhën: 01.01.2000 - 31.12.2017;
- Vendimi për dhënjën në shfrytëzim të lokaleve të palestra “Mizahir Isma”;

Në mujin mars, kanë filluar punimet në ndërtimin e fazës së parë të Parkut Industrial në Optrushë, projekt ky i cili do të bashkëfinancohet nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe Komuna e Rahovecit. Vlera e këtij memorandumi është: 1,688,216.52€, ku 1.5 milion do të financohet nga MINT, ndërsa pjesa tjetër nga komuna e Rahovecit.

Punimet në këtë projekt kanë vazhduar gjatë gjithë vitit, duke i realizuar këto pozicione: hapja e rrugëve, shtrirja gypave për ujërat e zeza dhe ato atmosferike, si dhe rrafshimi i parcelave.

Shih foto 1 dhe 1.1



TM2, 2023

Gjatë tre mujorit të dytë, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Rahovec, ka zhvilluar këto aktivitete:

Me datë 05.04.2023, IOM përmes Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Rahovec, ka ndarë 66 kuponë (voucher) me vlerë nga 100 deri në 300 euro për familjet e prekura nga vërshimet e datës 17.09.2022, të cilat janë kushte jo të mira ekonomike;

Shih foto 1.2 dhe 1.3



Më 27 dhe 28 prill, u organizua Panairi Ndërkombëtar i Turizmit i cili u mbajt në Prishtinë, në këtë panair mori pjesë edhe Komuna e Rahovecit, me të cilin rast u prezantuan monumentet e trashëgimisë kulturore, si dhe resurset turistike të Komunës së Rahovecit.

Me qëllim të sensibilizimit dhe informimit rreth aplikimit në thirrjet për grante, Komuna e Rahovecit, në bashkëpunim me akter të tjerë organizoj sesione informuese për bizneset e Komunës sonë.

- Sesion informues rreth aplikimit për grante në fondet të IPA-s.
- Sesion informues për grante. Ky sesion informues është organizuar nga Syri Vizion në bashkëpunim me DEZHT-in.
- Sesion informues për thirrjen e granteve për bizneset, të cilën e ka hapur Ministria e Zhvillimit Rajonal. Ky sesion informues u organizua nga DEZHT-i, në bashkëpunim me Agjencionin Zhvillimor Rajonal.

Është mbajtur takimi i dytë i këshillit publiko-privat, ku u diskutuan çështje të ndryshme rreth zhvillimit ekonomik lokal në Rahovec.

Në kuadër të projektit “Eco Routes”, është bërë shenjëzimi i 20 kilometrave shtigjeve të ecjes (Hiking) në zonën Zatriqit dhe Kaznikut.

Për qëllim të rritjes së bashkëpunimit me ndërmarrjet private, bashkë me Drejtorin e Bujqësisë z. Berat Duraku, i kemi vizituar 3 biznese të mëdha në Komunën e Rahovecit: Stone Castle, Osa Termosistem dhe Haxhijaha.

Me qëllim të krijimit të kushteve që të rinjëve të Komunës së Rahovecit, t’u mundësohet fillimi i karrieres së tyre përmes një praktike 6 mujore me pagesë, Komuna e Rahovecit, respektivisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi, me 29 qershor 2023, është hapur thirrje publike për praktikë 6 mujore me pagesë në parteneritet publiko-privat. Në këtë thirrje kemi pranuar 47 aplikacione të profileve të ndryshme, ku 37 prej tyre kanë arritur të kalojnë fazën e parë. Në mungesë të gatishmërisë së bizneseve për angazhimin e këtyre të rinjeve, ne kemi arritur që 11 prej tyre tu mundësojmë mbajtjen e kësaj praktike, sipas thirrjes publike.

Shih foto 1.4



Në muajin qershor kanë përfunduar të gjitha punimet në projektin Renovimi i Shtëpisë së Verërave. Përmes kësaj kontrate, është bërë renovimi i brendshëm dhe i jashtëm i shtëpisë së verërave.

Shih foto 1.5



TM3, 2023

Gjatë tre mujorit të tretë, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Rahovec, ka zhvilluar këto aktivitete:

Në muajin gusht më datë 02.08.2023 është mbajtur takimi i këshillit publiko-privat takim ky i cili u mundësua nga komuna e Rahovecit në bashkëpunim me USAID-in, përmes Programit Qeverisja e Pronës. Në këtë takim morën pjesë rreth 20 biznese duke përfshirë edhe bizneset nga diaspora. Në këtë takim u diskutuan këto tema:

- Kontributi i bizneseve të mërgatës në zhvillimin ekonomik lokal në Komunën e Rahovecit dhe mundësitë e bashkëpunimit;
- Dialogu publiko-privat: sfidat dhe çështjet e ndërlidhura me pronën komunale, partneritetin publiko-privat dhe mbështetjen e bizneseve me pronare gra.
Në këtë takim u bë prezantimi i listës të pronave të lira komunale
- Prezantimi i Listës së Pronave Komunale për Dhënie në shfrytëzim dhe Këmbim 2023, dhe nevojat e sektorit privat për shfrytëzimin e pronës komunale.

Më datë 01.09.2023 është bërë përrurimi i shtëpisë për të moshuar, projekt ky i cili do të mundësojë qëndrim ditor për të gjithë të moshuarit (pensionistët) të komunës së Rahovecit.



TM4, 2023

Gjatë tre mujorit të katërt, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Rahovec, ka zhvilluar këto aktivitete:

Më datë: 08.12.2023, u nënshkruan marrëveshjet për subvencionimin e 19 bizneseve të Komunës së Rahovecit. 11 prej tyre ishin biznese të cilat merren me punë artizanale, që menaxhohen nga gratë, 2 biznese të cilat merren me ushqime tradicionale dhe 6 prej tyre përpunues të drurit dhe të metalit.

Shih foto 1.6



Më datë 18.12.2023, ka filluar kompensimi i dëmeve në ekonomi familjare dhe amvisëri të cilat u shkaktuan nga vërshimet e datës 17.09.2022;

Në muajin dhjetor, kryesisht angazhimet e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm kanë qenë të fokusuar në inkasimin e të hyrave në qira dhe në taksa afariste.

Në projektin: “Ndërtimi i Lokaleve Afariste Zejtare në Rahovec”, punimet janë zhvilluar gjatë gjithë vitit 2023, dhe sipas planit dinamik, ky projekt pritet të përfundoj në tre muajin e parë të vitit 2024.

Shih foto 1.7 dhe 1.8



SEKTORI PËR EKONOMI

Në tremujorin e parë të vitit 2023, janë përgatitur aktvendimet për të gjitha bizneset që janë të ngarkuara me taksë afariste komunale.

Në kuadër të taksave afariste për ushtrimin e veprimtarive ekonomike, janë inkasuar mjete gjatë gjithë vitit 2023. Për të gjitha bizneset të cilat kanë pasur vonesa në pagesat e taksave afariste, me kohë janë dërguar vërejtje me shkrim. Pavarësisht vështirësive që kishim në realizimin e të hyrave, inkasimi ka qenë i kënaqshëm pasi që të hyrat tejkaluan planin për 7.52%

Të hyrat në taksën afariste komunale:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Planifikimi i të hyrave në taksa afariste për vitin 2023	75,000.00€
2	Të hyrat në taksën afariste për vitin 2023	81,103.50€
3	Tejkalimi i planit për të hyrat në taksa afariste	6,103.50€
4	Tejkalimi i planit për të hyrat në taksa afariste të shprehura në %	7.52%

SEKTORI I ASETETEVE

Punët dhe detyrat e punës janë kryer me përgjegjësi të plotë, me profesionalizëm dhe në harmoni me detyrat e përcaktuara nga menaxheri.

Të gjitha transaksionet në asetet komunale janë të regjistruara me kohë për vitin 2023, poashtu me kohë është bërë amortizimi i aseteve komunale për vitin 2022.

Regjistrimet e aseteve janar-dhjetor 2023

Përshkrimi	Numri I regjistrimeve	Vlera në Euro
Regjistrimet Mbi 1,000.00€	338	7,682,752.00€
Regjistrimet nën 1,000.00€	121	25,342.00€
	459	7,708,094.00€

SEKTORI PËR ZHVILLIM

Evidenca e të hyrave dhe e ngarkesës së qirasë së lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit, sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon Komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt.

Në periudhën janar-dhjetor 2023, janë lëshuar gjithsej 105 pëlqime të punës.

Inkasimi i të hyrave në këtë sektorë ka qenë i kënaqshëm pasi që të hyrat që ralizuam në vitin 2023, tejkaluan planin për 32.47%.

Të hyrat nga qiraja, janar-dhjetor:

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Planifikimi i të hyrave në qira për vitin 2023	82,000.00 €
2	Të hyrat nga qiraja për periudhën janar-dhjetor 2023	121,429.16 €
3	Tejkalimi i planit për të hyrat në qira	39,429.16 €
4	Tejkalimi i planit për të hyrat në qira të shprehura në %	32.47%

ZYRA E QKRB-së:

Evidenca e regjistrimit të bizneseve në Komunën e Rahovecit, sipas bazës së programit online të ARBK-së, mbahet në mënyrë të rregullt.

Tabela e kërkesave dhe regjistrimit të bizneseve për periudhën Janar-Qershor 2023

Nr	Përshkrimi	Totali
1	Biznese të regjistruara SH.P.K	88
2	Biznese të regjistruara B.I	78
3	Kërkesa për informata	170
4	Kërkesa për shtim apo heqje të aktiviteteve	40
5	Kërkesa për ndryshim adrese	22
6	Kërkesa për ndryshim pronari	7
7	Kërkesa për ndryshim të drejtorit, apo përfaësuesit të autorizuar	6
8	Ndryshimi i emrit tregtar	4
9	Kërkesa për ndryshimin e numrit të punëtorëve	3
10	Kërkesa për ndryshim të bordit	1
11	Kërkesa për çertifikatë duplikat	1
12	Kërkesa për ndryshim të emrit	1
13	Kërkesa për ndryshim të kapitalit	1
14	Shuarje të biznesit	53
15	Kërkesa për shtim apo heqje të njësisë	12
16	Vërtetime individuale	55
17	Vërtetime të biznesit	4
18	Të ndryshme	40
19	Çertifikata të dëmtuara	10
20	Çertifikata N.U.I	62
	Total	658

SEKTORI I TURIZMIT

Zyra për Informacione Turistike, gjegjësisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, i ka zbatuar detyrat dhe obligimet e muajit janar-dhjetor 2023, si në vijim:

Janë mbajtur takime të rregullta me organizatën e UNDP-së, në lidhje me projektin për Programin Rajonal 2, i cili do të zgjatë deri në fund të vitit 2024.

Në kuadër të turizmit, është lansuar Harta Turistike Dixhitale në komunën e Rahovecit, ku përmes sistemit CR cod, mundësohet promovimi i atraksioneve turistike dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore. Kjo hartë është e pasuruar me 108 objekte turistike dhe kulturore.

Planifikimi, organizimi dhe mbajtja e intervistave një javore me kompanin mediale DBCom Media, nga të Motreal të Kanadasë dhe kompanisë CANAL+ bazuar në Francë, me qëllim promovimin dhe marketingun e Rahovecit dhe Kosovës në nivel ndërkombëtar.

Hapja e thirrjes së dytë të programit të UNDP-së, Reload 2, dhe Komunës së Rahovecit, për OJQ-të e komunës sonë. Përzgjedhja dhe përkrahja finaciare e 6 projekteve më të mira të OJQ-ve të cilat u dedikohen të rinjëve, fëmijë me nevoja të veqanta dhe turizmit në Komunën e Rahovecit.

Drejtoria për DEZHT

Erhan Morina
